



Pranimi / Doretimi Prijemno / Prodato Received / Delivered	30-03-2022	2	viti god year
Organ / Shkronja Organ / Jedinka Org / Abnt	SK/MS/FOK	17/16/2022	111
Br. Prot. Br. Prot.			
Shitja Protog. Appendix			
Sasia Kolicina Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 18 /2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë
- Arkivin të Këshillit.



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primar / Dorezuar Priljeno/Prifato Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinite./ Org /Unit	nr Prot nr Prot Prot No	Shtup-a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	1716/2022		1121



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT
PËR VITIN 2020

në

MINISTRINË E DREJTËSISË

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJE.....	2
HYRJE.....	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT.....	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....	5
FUSHA E MONITORIMIT.....	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË MINISTRINË E DREJTËSISË	7

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këtë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efikase, sipas standardeve më të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJSLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË MINISTRINË E DREJTESISË PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Drejtësisë për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në këtë ministri me datën 11.02.2022, në prezencë të Menaxherit të Personelit, si mostra për shqyrtim ka marrë një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim: Rregulloren Nr.12/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshme në Ministrinë e Drejtësisë, Rregullore QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshme në Ministrinë e Drejtësisë; Vendimin e datës 21.04.2020, për emërimin e grupit punues për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm; Planin e rekrutimit për vitin 2020, nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër protokollit 02-894 i datës 26.11.2020, për caktimin e zëvendësuesit, bashkangjitur komplet dosja e nëpunësit civil; Vendimin me numër protokollit 02-34 të datës 13.01.2021, për caktimin e zëvendësuesit, bashkangjitur komplet dosja e nëpunësit civil; Njoftimin me numër protokollit 569 i datës 17.07.2020 nga Drejtori i DASHC-së; Vendimin me numër protokollit 02-3188/2 të datës 29.07.2020, mbi shfuqizimin e caktimit të zëvendësuesit, Vendimin me numër protokollit 02-109/2 të datës 29.07.2020, mbi shfuqizimin e caktimit të zëvendësuesit; Vendimin me numër protokollit 02-3220/2 të datës 29.07.2020 mbi shfuqizimin për caktimin e përkohshëm dhe kthim në vendin e punës sipas akt emërimit; Vendimin me numër protokollit 01-891 të datës 25.11.2020, për caktim të zëvendësuesit; Vendimin me numër protokollit 01-894 të datës 26.11.2020, për caktim të zëvendësuesit; Vendimin me numër protokollit 02-344 i datës 22.04.2020, për aprovim të kërkesës për dorëheqje, të bashkangjitur kërkesën e datës 31.01.2020, 29.01.2020, si dhe vendimin e datës 10.02.2020; Vendimin me numër protokollit 02-691 të datës 07.09.2020 për emërimin e Komisionit disiplinor; Vendimin me nr. protokollit 02-4300 të datës 29.07.2020 për shfuqizim të emërimit të Komisionit disiplinor; Vendimin me numër protokollit 02-3316/2 të datës 29.07.2020 për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e kontesteve dhe ankesave; Vendimin me numër protokollit 02-824 të datës 04.11.2020, për transferimin e përkohshëm; Vendimin me numër protokollit 02-710 të datës 16.09.2020, për transferimin e përkohshëm; Vendimin me numër protokollit 50 të datës 30.06.2020, për transferimin; Vendimin me numër protokollit 02-318 të datës 10.04.2020, për pushim të lehonisë; Vendimin me numër protokollit 03-522/2 të datës 10.07.2020, për pagesën me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes; Vendimin me numër protokollit 10/ML të datës 27.04.2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Vendimin me numër protokollit 01-821 të datës 03.11.2020,

për shfuqizim të vendimit nr. 96/2018 të datës 23.11.2018 për emërim ; Vendimin me numër protokolli 09-759 të datës 02.12.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 04-740 të datës 30.09.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 03-396 të datës 16.07.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 03-240 të datës 05.06.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 03-347/3 të datës 19.05.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 09-348/3 të datës 19.05.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 03-396/4 të datës 10.08.2020, nga Komisioni Disiplinor; Vendimin me numër protokolli 03-347/7 të datës 10.07.2020 së bashku me ankesë; Vendimin me numër protokolli 03-347/7 të datës 10.07.2020 i nxjerr nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër protokolli i 03-150/3 të datës 128.02.2020 i nxjerr nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në kërkesën e datës 12.03.2020, Ankesën me nr. 09-348/7 të datës 23.06.2020; Vendimin me numër protokolli 04-84/3 të datës 27.02.2020 i nxjerr nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër protokolli 09-348/10 të datës 10.03.2020 për Inspektoratin e punës; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 02.09.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë ligjore”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 09.07.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë ligjore”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 25.09.2020 për nëpunësin në pozitën Udhëheqës i divizionit për drejtësi tranzicionale; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 17.07.2020 për nëpunësin në pozitën “Asistente ekzekutive”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 02.09.2020 për nëpunësin në pozitën “Zyrtar i lartë ligjor”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 09.03.2020 për nëpunësin në pozitën “Drejtor i Departamentit për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 01.09.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë për integrim evropian”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 02.09.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë ligjore”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 03.09.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë ligjore”; Formularin për vlerësimin e punës provuese të datës 15.09.2020 për nëpunësen në pozitën “Zyrtare e lartë për komunikim me publikun”; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga KPMSHCK e datës 19.08.2020, të bashkangjitur Vendimet me numër Anr.367/2020, A.nr.386/2020, A.nr.384/2020, A.nr.375/2020, A.nr.292/2020, A.nr.294/2020, A.nr.295/2020, A.nr.293/2020, Vendimet A.nr.291/2020; Plani vjetor i trajnimeve të nëpunësve civil për vitin 2020; Kërkesat e pushimeve të nëpunësve civil për vitin 2020; Listën e nxjerr nga sistemi elektronik për hyrje- daljet e nëpunësve civil për vitin 2020; Listën e pagave për nëpunësit civil në Ministrinë e Drejtësisë, për një muaj, vitin 2020; Pasqyrën me vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit civil në Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2020.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

\Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Ministrinë Drejtësisë me datën 11.02.2022, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2013 me plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje me numër Nr.12/2018, mirëpo që e njëjta nuk ka hyrë në fuqi dhe është duke u zbatuar ajo e vitit 2013, është përfunduar klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës në bazë të rregullores së vjetër, mirëpo nuk ka përfunduar klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës sipas rregullores së re. Në këtë institucion janë të punësuar 206 nëpunës civil.

Kolegji ka analizuar dosjet e tre (3) nëpunësve civil, mirëpo si mostra janë marr dokumentacionet e dosjeve për këto pozita: *Inspektor i MD-së për inspektimin e punës në SHKK*, *Zyrtare e lartë për integritet evropiane* dhe *“Zyrtare e arhivës”* dhe si rrjedhojë ka konstatuar këto të gjetura :

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në dosjet e analizuara për pozitat e lartcekura, tek asnjëra dosje nuk ekzistojnë formularët e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, me këtë Kolegji vlerëson se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 dhe 1.19 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, respektivisht shtojcës 1.1 pika 17 dhe 18 të kësaj rregulloreje, sepse Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, ndërsa Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale siç parashihet me paragrafin 4 të këtij neni, po ashtu kanë munguar edhe planet e punës për nëpunësit civil, e krejt kjo në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe përdorimin e dosjes së personelit dhe sistemit informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar po ashtu se në dosjen e nëpunësit civil për pozitën Inspektor i MD-së për inspektimin e punës në SHKK, mungon formulari për rezultatin e vlerësimit të punës për vitin 2020, qe është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2. Ushtruesit e detyrës: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve me ushtrues detyre në Ministrinë e Drejtësisë dhe deklarimeve të Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore, ka konstatuar që gjatë vitit 2020 ka pasur pesë (5) pozita me ushtrues detyre respektivisht me zëvendësime, mirëpo gjatë shqyrtimit të këtyre vendimeve kemi konstatuar që këto vendime janë nxjerrë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe të nenit 32 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Neni 30 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktonte se: *Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj, ndërsa në rastin konkret është tejkaluar afati ligjor.*

Ligji Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 83 paragrafi 10 parasheh se: *Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës.*

Kurse me nenin 32 paragrafi 4 të Ligji Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë përcaktohet se: *Përjashtimisht, një pozitë e rregullt pune në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të një nëpunësi civil varësisht nga rasti, për një periudhë jo më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj. Në këtë rast, procedurat e pranimit zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.*

Këshilli vlerëson së dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19

paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kritereve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të bëhet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla bëhet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur të zbatoj procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljeve të konstatuara në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të bëhet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë

E GJETURA 3: Këshilli, gjatë monitorimit të zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Ministrinë e Drejtësisë, ka gjetur se Njësia për Burime Njerëzore ka përgatitur listën e nëpunësve civil dhe deklarimin e statusit të zyrtarëve publik dhe të njëjtën e ka përcjell për verifikim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo ende nuk ka përfunduar procesi i deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë, sepse nuk ka verifikim nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 16 përcaktohet se: 16. *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për*

Procedurën Administrative. Procedura lidhur me deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë është përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Këshilli, konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publik ka qenë obligim ligjor që është dashur të përfundoj brenda afateve ligjore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, që të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë dhe të sigurohet se deklarimi i statusit të bëhet përmes nxjerrjes së aktit administrativ sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, lidhur me këtë fushë të monitorimit ka konstatuar së Ministria e Drejtësisë ka përgatitur planin e personelit për vitin 2020, dhe ka zhvilluar 2 procedura të rekrutimit, mirëpo që të njëjtat janë anuluar, me arsyeshmërinë e hyrjes në fuqi Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe situatës së pandemisë Covid 19.

Tek pjesa e nëpunësve që kanë qenë të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për vitin 2020, Kolegji gjatë monitorimit në këtë institucion ka konstatuar se një nëpunës në pozitën *Ekspert financiar*, ka qenë i angazhuar sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta që është lidhur në vitin 2019, ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2020, mirëpo që nëpunësi pas kësaj periudhe ka ofruar dorëheqjen, dhe organi i punësimit me datë 22.04.2020 ka nxjerrë vendimi mbi shkëputjen e kësaj kontrate.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Këshilli, gjatë monitorimit të kësaj fushe ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë për vitin 2020 ka nxjerrë vendimin me numër ZSP-Nr.44/2020 të datës 29.07.2020, lidhur me formimin e Komisionit Disiplinor në përbërje të tre (3) anëtarëve duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit nr.06/L-114

për Zyrtarët Publikë, njëkohësisht ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.119/2018 të datës 22.11.2018 për emërimin e Komisionit Disiplinor sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

E GJETURA 4: Këshilli gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër ZSP-Nr.49/2020 të datës 07.09.2020 për themelimin të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë, ka konstatuar se tek anëtarët e komisionit është përshkruar vetëm “kryesues dhe anëtarët”, ndërsa nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtareve të këtij komisioni. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 49 paragrafi 5 ka *përcaktuar që Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor*, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Bazuar në 10 paragrafi 2 përcaktohet që: *“Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional –anëtar dhe Nëpunës civil i njesisë së burimeve njerëzore – anëtar”*. Meqenëse kjo dispozitë ka përcaktuar që duhet të përshkruhen edhe pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor, atëherë Ministria e Drejtësisë nuk ka bërë një përshkrim të tillë, rrjedhimisht edhe fryma e normës nuk është zbatuar si tërësi.

Rekomandimi 4: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, që të bëjë plotësim/ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe në vendim të përshkruhen edhe pozitat që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët siç parashihet me nenin 10 të Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

E GJETURA 5: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë për vitin 2020 ka iniciuar gjashtë (6) procedura disiplinore prej të cilave janë nxjerrë edhe vendimet nga ana e Komisionit Disiplinor. Këshilli nga analizimi i vendime të nxjerra nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2020 ka konstatuar se për pozitën e nëpunësit civil *Zyrtar Ligjor në Departamentin për Bashkëpunim Juridik ndërkombëtar* është përfunduar procedura disiplinore pas tërheqjes se inicimit të procedurës nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, për nëpunësin civil në pozitën *Përkthyes anglisht-shqip* në Departamentin për Financa për Shërbime të Përgjithshme, Komisioni Disiplinor ka liruar nga përgjegjësia disiplinore nëpunësin civil lidhur me shkelje të rëndë e iniciuar nga udhëheqësja e divizionit të burimeve njerëzore, si dhe për ankuesin në pozitën *Toksikolog Mjeko Ligjor* në Institutin e Mjekësisë Ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil lidhur me masën e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor, ka

vendosur me datën 25.01.2021 sipas vendimit me numër A.nr.442/2020 dhe është shpallur jo kompetent mbi bazën e ankesës së ankuesit. Ndërsa për rastet dhe pozitat si në vijim: “Zyrtare e lartë për buxhet dhe zotim”, “Inspektor në Inspektoratin e MD për SHKK” dhe “Asistent i Morgut në Divizionin për Mjekësi Ligjore”, Kolegji ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka shqiptuar masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil*”, masa këto që nuk janë në kompetencë e Komisionit Disiplinor sepse në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nën paragrafit 1.1.2, shqiptimi i vërejtjes me shkrim është në kompetencë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit, po ashtu sipas Këshillit shqiptimi i vërejtjeve nga Komisioni Disiplinor është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. E po ashtu Kolegji i Këshillit ka konstatuar se këto masat disiplinore ” *Vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil*” të shqiptuara nga ana e Komisionit Disiplinor janë shqiptuar jashtë afatit ligjor siç parashihen me dispozitat e nenit 7 paragrafit 2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil. Tek masa e shqiptuar vërejtje me shkrim për pozitën “Zyrtare e lartë për buxhet dhe zotim”, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë ka shqiptuar këtë masë bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil mirëpo vendimi është nxjerrë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së vendimet në fjalë anë vendime të paligjshme bazuar në 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2,1,3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;*

Rekomandimi 5: Rekomandojmë Menaxherin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë që masat disiplinore *Vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil* të shqiptuara nga Komisioni Disiplinor të shlyhen dhe të njëjtat të largohen nga dosjet e nëpunësve civil në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) NR. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë vendimin me numër ZSP-Nr.93/2018 të datës 24.08.2018, lidhur

me formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mirëpo me datë 29.07.2020 kjo ministri konkretisht Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerrë vendimin me numër ZSP-Nr.40/2020, me të cilin ka bërë shfuqizimin e këtij vendimi duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 dhe nenin 83 paragrafin 17 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se gjatë vitit 2020 Ministria e Drejtësisë ka pranuar pesë (5) ankesa të nëpunësve, prej të cilave për dy ankesa ka vendosur me vendim Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe për tri (3) tjera ka nxjerrë vendimi lidhur me jo kompetencën e tij për shkak se nuk kanë qenë pozita të shërbimit civil. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se gjatë vitit 2020 në Këshill janë pranuar 10 ankesa nga nëpunësit kundër Ministrisë së Drejtësisë e për të cilat ka vendosur Këshilli me vendim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Këshilli gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil ka konstatuar se sipas Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, kjo ministri ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civil dhe nuk ka asnjë nëpunës të cilit ndaj të cilit është bërë vlerësimi i rezultateve në punë. Në vitin 2020 për dhjetë (10) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 6: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, nga mostrat në dosjen e nëpunësit për pozitën *Inspektor i MD-së për Inspektimin e punës në SHKK*, ka konstatuar që formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020 nuk është në dosjen e nëpunësit, respektivisht rezulton se ndaj të njëjtit nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, krejt kjo në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji vlerëson se mos vlerësimi i punonjëse nga ana e mbikëqyrësit të drejtpërdrejt konsiderohet mos përmbushje e detyrave të punës dhe si e tille konsiderohet shkelje disiplinore.

Rekomandimi 6: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Menaxherin e Personelit të Ministrisë së Drejtësisë që të kenë mbikëqyrje tek udhëheqësit që vlerësimet e rezultateve të punës duhet të bëhen për të gjithë nëpunësit civil dhe brenda afateve ligjore ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

E GJETURA 7: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për dhjetë (10) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese dhe nga shqyrtimi i dosjes se nëpunësit civil për pozitën “Zyrtare e lartë ligjore” në Divizionin për Hartimin dhe Negocimin e Marrëveshjeve Bilaterale është konstatuar që data e fillimit të marrëdhënies se punës për këtë pozitë, ka qenë 02.09.2019, ndërsa vlerësimi i periudhës provuese është bërë me datë 02.09.2020, kështu që Kolegji ka konstatuar që nuk janë respektuar afatet për vlerësim të punës provuese siç parashihet me Kapitullin III respektivisht nenin 37 dhe 38 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 7: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, që të ndërmarrin masat e nevojshme që në të ardhmen për të gjithë nëpunësit civil që janë në periudhë provuese, vlerësimi t’i bëhet duke u respektuar procedurat dhe afatet sipas Kapitullit III të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë konkretisht Njësia e Personelit, evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në formën elektronike dhe fizike. Sipas të dhënave nga kjo njësi, del se gjatë vitit 2020 numri i përgjithshëm në kuadër të kësaj ministrie 330 nëpunës kanë shfrytëzuar pushimin vjetor, 33 nëpunës kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor e që sipas dokumentacionit të dërguar nga Zyra e Burimeve Njerëzore del se kanë të bashkangjitura kërkesat lidhur me pushimin vjetor dhe aprovimin nga Udhëheqësit e tyre si dhe dëshmitë e bashkangjitura mbi shfrytëzimin e pushimeve mjekësore, kështu që mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores

(QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Drejtësisë gjatë vitit 2020 ka pasur tri (3) transferime, ku njëra prej tyre ka qenë transfer i përhershëm brenda institucionit bazuar në dispozitat e Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe dy (2) transferime të përkohshme për interes të institucionit, bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Lidhur me këtë fushë, Kolegji ka gjetur:

E GJETURA 8: Kolegji gjatë monitorimit në këtë institucion, ka konstatuar se Vendimi ZSP-Nr.51/2020 i datës 16.09.2020, sipas të cilit nëpunësi civil në pozitën e Zyrtar Ligjor në Divizionin për Bashkëpunim në Çështje Civile dhe Penale i transferuar në pozitën Zyrtar Ligjor në Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, dhe Vendimi ZSP-Nr.57/2020 i datës 04.11.2020, sipas të cilit nëpunësi nga pozita Zyrtar Ligjor nga Divizioni për Bashkëpunim në Çështje Civile dhe Penale i transferuar në pozitën Zyrtar Ligjor në Divizionin për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, janë nxjerrë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë e jo nga ana e Njësisë përgjegjëse të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Rekomandimi 8: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Menaxherin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, që në rastet e transferimit të stafit të veprojnë në pajtim me nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë ka të punësuar 206 nëpunës civil prej tyre 203 janë shqiptar, 1 serb, 1 turk, 1

rom, prej 206 nëpunësve civil 91 janë të punësuar femra dhe 115 janë meshkuj, ndërsa ky institucion ka të punësuar 1 nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara (nëpunës i verbër).

E GJETURA 9: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se nuk ka përfaqësim të barabartë të gjinive siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Po ashtu lidhur me punësimin e personave me aftësi të veçanta, nuk kemi respektim të Ligjit Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një nëpunës duhet me qenë person me nevojë të veçanta.

Sipas nenit 12 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara Punësimi në tregun e hapur të punës *1. Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara. 2. Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.*

Rekomandimi 9: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë që me rastin e rekrutimit të stafit të ri që të ketë parasysh respektimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore si dhe nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 të Ligji Nr. 03/L-019 Për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, ashtu që për çdo 50 punëtorë një nëpunës civil duhet të jetë nëpunës me aftësi të kufizuara.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se në Ministrinë e Drejtësisë, nuk ka pasur nëpunës civil me pezullim të dakorduar të punës, ndërsa ndaj dy (2) nëpunësve civil është nxjerrë vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, si dhe ndaj një nëpunësit civil është nxjerrë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes mirëpo që i njëjti nuk ka qenë nëpunës civil. Ndërsa në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që nuk ka pasur nëpunës civil ndaj të cilëve është ndërprerë marrëdhënia e punës me shkarkim, që i është përfunduar marrëdhënia e punës, ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësim me afat të caktuar, dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban edhe pozitë të shërbimit civil si dhe post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Drejtësisë nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë penale ndaj ndonjë nëpunësi civil po ashtu nuk ka asnjë nëpunës që është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Ministrinë e Drejtësisë respektivisht Zyra e Personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve për të gjithë nëpunësit civil në dosjet e tyre sipas Formularit numër 3, në këtë institucion gjatë vitit 2020 dy (2) nëpunës civil kanë ndjekur trajnimet e nevojshme për institucionin.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohen në pajtim me akt emërimet, përveç zyrtarëve të Teknologjisë Informative për të cilët aplikohen shtesa nuk aplikohet asnjë shtesë tjetër për nëpunësit civil.

E GJETURA 10: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil gjatë monitorimit në këtë institucion, ka konstatuar se pozita *Mbrojtës rezident i viktimave* është pozitë me koeficient 6.5 ndërsa nëpunësi civil paguhet me koeficient 5, e krejt kjo në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil.

Rekomandim 10: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, që të ndërmarrë veprimet ligjore lidhur me atë që të bëhet kompensimi i nëpunësve civil në pajtim me akt emërimet e tyre sipas nenit 8 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil.

14. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit në institucionin e Ministrisë së Drejtësisë, nuk është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për vitin 2019 nuk ka pasur rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka qenë jo funksional në mungesë të kuorunit. Lidhur me zbatimin e vendimeve të Këshillit, Kolegji ka konstatuar se gjatë vitit 2020 ka pranuar dhjetë (10) vendime të Këshillit për zbatim, të cilat janë zbatuar nga Ministria e Drejtësisë.

16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e monitorimit, ka konstatuar dhjetë (10) të gjetura dhe ka dhënë dhjetë (10) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Ministrisë së Drejtësisë, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Ardita Haxhnikaj-Demir


Kryetare e Kolegjit

Ardita Perçuku-Shipi


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Raporti i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK .